VENDIM
Nr. 112/2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 65/2020, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, nenit 29, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 65/2020, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionit të Prokurimit Publik", të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 2.11.2023.

Lidhja nr. 2. STRUKTURA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

	Kategoria	
Pozicioni	**Nga:**	**Bëhet:**
Këshilltar	II-B	I-4
Sekretar i Përgjithshëm	I-B	I-2
Drejtor	II-B	II-1
Inspektor	III-A	III-1
Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor		
Përgjegjës sektori	III-A	III-1
Specialist jurist	III-B	IV-1
Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve		
Përgjegjës sektori	III-A	III-1
Specialist (financë)	III-B	IV-1
Specialist (buxheti)	III-B	IV-1
Specialist (Protokolli)	IV-A	IV-2
Specialist (sekretari/arkiv)	IV-A	IV-2
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve	III-B	IV-1
Specialist Integrimi/Marrëdhënieve me Jashtë	III-B	IV-1
Sanitar		I
Shofer		III
Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit		
Përgjegjës sektori	III-A	III-1
Specialist (redaktor letrar)	III-B	IV-1
Specialist Statistikash	III-B	IV-1
Specialist (IT)	III-B	IV-1
Specialist Publikimi	III-B	IV-1